



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 712 prot.

Tiranë, më 14.04.2026

V E N D I M

Nr. 83, datë 14.04.2026

Mbështetur në nenin 32/1/c, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar¹ dhe bazuar në informacionin e marrë gjatë transmetimit të emisionit “Living Day”, më datë 03.10.2025, në Televizionin Vizion Plus² dhe emisionit “Studio Live”, më datë 10.12.2025, në Televizionin Report³, lidhur me gjuhën e përdorur nga z. Z.I kundrejt personave që i përkasin komunitetit LGBTI, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴, me urdhrin nr. 151, datë 17.12.2025, ka filluar procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me gjuhën e përdorur nga z. Z.I ndaj personave LGBTI, të bëra në këto media audiovizive.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Referuar informacionit të marrë gjatë transmetimit të emisionit “Living Day”, të datës 03.10.2025, në televizionin Vizion Plus Tv, rezulton se, në këtë emision ka qenë i ftuar z. Z.I . Diskutimet e zhvilluara midis drejtueses së emisionit dhe z. I. në cilësinë e të ftuarit, kanë qenë disa nga temat që kanë ngjallur debat pas qëndrimeve të mbajtura ky i fundit, ka mbajtur. Gjatë emisionit diskutimi është përqendruar tek qëndrimet e mbajtura nga z. I. ndër të tjera, ndaj vaksinës anti-covid dhe ligjit të barazisë gjinore.

Gjatë diskutimit të zhvilluar mbi ligjin e barazisë gjinore, **gazetarja** i është drejtuar z. I. , duke i thënë: “Me ligjin e barazisë gjinore je treguar i rreptë”.

Z.I. , në fjalën e tij është përgjigjur: “Çfarë është kjo fjalë barazi gjinore? Pse jeni në kundër fazë me atë që thoni. Çdo me thënë barazi gjinore? Jemi të barabartë unë dhe ti nga gjinia?”

Gazetarja: Jo nga gjinia nuk jemi të njëjtë.

Z. I. : Atëherë nga doli barazia gjinore. Nga doli si term.

Gazetarja: Atëherë themi gjini përgjithësuese.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² <https://www.youtube.com/watch?v=TxueHiEgatA>

³ <https://www.youtube.com/watch?v=07-EFFwZxvI>

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Z. I. : Jo. Janë të veçanta. Nuk i përgjithëson dot. Moj ti zonjë, nuk e bën dot Z. femër tani ti. Unë nuk të bëj dot ty mashkull. Çfarë janë këto terma që gënjejnë rininë edhe të vegjlit. Jo ju, po shteti që i çon nëpër shkolla dhe reklamojnë këtë të ashtuquajturën barazi gjinore ose orientim seksual. Nuk e di, e keni parë para një muaji një zonjë që thotë ia morën vajzën 13 vjeçe në moshën e pubertetit, e çuan dhe i hoqën gjoksin sepse duhej të ndihej si djalë? Këto janë krime kundër njerëzimit. Askush nuk i ka dënuar deri tani, sepse nuk duan ata, nuk lënë ata të 300-tët. Ata të “bilderbergut”, ata “Masonët” që po bëjnë krime monstruoze në të gjithë botën. Ata të “Sorosit” me shokë.

Gazetarja: Po ju, pse jeni kundër martesave brenda të njëjtës gjini?

Z. I. : Të lutem, mos thuaj më martesë brenda gjinie, të njëjtën gjini.

Gazetarja: Si ta them?

Z.I. : Po ç’martese është? Martesa e di çfarë është? Ju e bastardonit edhe kuptimin, domethënien e fjalës martesë. Martesë do të thotë të martohen dy të kundërt. Nuk thotë që të bashkëjetojnë dy njëlloj. Se do më detyrosh të flas pa edukatë pastaj.

Gazetarja: Jo, të lutem, se jemi edhe në një orar ku na ndjeke gjithë familja. Kështu që duhet të jemi të kujdesshëm me termat.

Z.I. : Atëherë. Çfarë martese do të bëjnë dy burra me njëri tjetrin?

Gazetarja: Atëherë si ta quajmë?

Z.I. : Të lutem. Çfarë do bëjnë?

Gazetarja: Si ta quajmë? Ata duan të martohen.

Z. I. : Moj çdo me thënë të martohesh? Çfarë do prodhojnë?

Gazetarja: Po unë nuk them se do prodhojnë diçka? Po ata duan të martohen.....

Z.I. : Po kush i ndaloi të martohen? Të vrasin veten. Në krevat të bëjnë çfarë të duan. Të mos më dalin mua nëpër shkolla dhe të thonë që është e ligjshme, është e drejtë të martohen një burrë me një burrë, e një grua me një grua. Unë kundër kësaj jam. Këta që martohen kështu, që bëjnë martesa burrë me burrë, grua me grua, unë dua t’i zhduk të tërë.

Gazetarja: Jo të lutem.

Z.I. : Është përgjegjësia ime zonjë.

Gazetarja: E kuptoj, e kuptoj.

Z.I. : Jam vet përgjegjës për atë që them. Këta janë kundër njerëzimit. këta janë kundër natyrës njerëzore. Këta janë kundër besimit në zot. Këta janë rundimente të shoqërisë. Duhet të zhduken. Shqip.

Gazetarja: Avokat, nuk mendoni se liria juaj mbaron aty ku fillon liria e tjetrit?

Z.I. : Cila liri?

Gazetarja: Në këtë rast e komunitetit.

Z.I. : Po ka ca norma. Po, jo të lutem, edhe kafshët e kanë, ku fillon, mbaron liria e njërit, vazhdon e tjetrit. Por janë kafshë. Ndërsa ne jemi njerëz. Ne jetojmë në shoqëri.

Gazetarja: Jeni duke i fyer, avokat.

Z.I. : Të lutem, nuk është liri dhe e drejtë që ti të japësh një shembull negative vajzës time apo djalit tim. Se ke këtë të drejtë. Bëj ç’të duash në krevat. Mos e deklaro. Mos më dil aty që të thuash jam...Se kjo nuk bëhet se ju prish puna për këta “të shkretët” në thonjëza, që martohen burrë me burrë dhe grua me grua. Po kjo bëhet për të reduktuar numrin e popullsisë, për të mos riprodhuar.

Është genocid në fakt. Praktikisht, martesë brenda seksit, e ashtuquajtura martesë, nuk është martesë, është genocid.

Gazetarja: Pa dashur edhe ju shkuat te fjala martesë.

Z.I. : Jo, jo, i përgjigjem nocionit tuaj. Për mua nuk ka martesë, nuk është martesë ajo.. Pra, kësaj bashkëjetese, që s'është martesë. Kjo bashkëjetesë është për të vrarë popullsinë. Dhe neve Shqiptarëve, kjo po na bën duke na përzënë.

Gazetarja: Pra për të reduktuar numrin e popullsisë, ashtu si ishte edhe vaksina thoni ju?.....

Diskutimi vazhdon me një tjetër tematikë.

Gazetarja: Avokat, pse bërtet dhe shan kaq shumë?

Z.I. : Po se më detyron ti....se më detyron të them atë që ndiej.

Gazetarja: Jo vetëm në këtë studio televizive, por vazhdimisht.

Z.I. : Unë nuk jam një njeri që bërtas.

Gazetarja: Është simbolike. Që e ngre zërin.

Z.I. : Shpërthim i natyrshëm kundër padrejtësisë e kundër krimit që i bëhet shoqërisë njerëzore. Po nuk jam nga ata që bërtasin, përkundrazi e kam zërin shumë të ulët në biseda me njerëzit, në biseda të këndshme. Po kur më thua “martesë” midis një burri dhe një gruaje, apo kur më thua atë fjalën tjetër barazia gjinore, hapu dhe të futem. Po ç'është kjo barazi gjinore, s'ka barazi gjinore.
.....”

Gjatë transmetimit të emisionit, me titra shfaqen në ekran “*Martesa brenda gjinisë, avokati I. : Janë kundër natyrës njerëzore.*” si dhe “*Avokati I. : Bëj çtë duash në krevat, mos ndiko tek fëmijët e mi.*”

Në profilin e televizionit Vizion Plus Tv në rrjetin social Facebook, janë publikuar pjesë nga diskutimi i mësipërm me përshkrimin “*Këta që martohen burrë me burrë dhe grua me grua duhet të zhduken*”, nuk përmbahet Z.I ”⁵. Emisioni i plotë është publikuar në kanalin zyrtar të televizionit Vizion Plus⁶.

Referuar informacionit të marrë gjatë transmetimit të emisionit “Studio Live”, të datës 10.12.2025, në televizionin Report Tv, rezulton se, në këtë emision ka qenë i ftuar z. Z.I . Diskutimet e zhvilluara midis drejtuesit të emisionit dhe z. I. në cilësinë e të ftuarit, kanë qenë disa nga zhvillimet kryesore në vend. Një nga çështjet e trajtuara ka qenë miratimi i ligjit për barazinë gjinore.

Gjatë diskutimit të zhvilluar mbi këtë çështje, **gazetari** i është drejtuar z. I. , duke i thënë: “*Profesor, një çështje shumë e rëndësishme është kalimi në heshtje i ligjit për barazinë gjinore që krijoi shumë debate, diskutime, përplasi politikën. Pse u zgjodh kjo formë? Pas shumë debateve, pas shumë*

⁵ <https://www.facebook.com/reel/25123620490664016>

⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=TxueHiEgatA>

diskutimeve, pas shumë përplasjeve të bëra nga ana e politikës apo eksponentëve të ndryshëm, Presidenti zgjedh që ta kalojë në heshtje, duke mos e dekretuar.”

Z.I. : Mund të më thoni ç’është ky ligj, se ç’përmbajtje ka? Më thoni përmbajtjen e këtij ligji?

Gazetari: Po ju pyes ju, duke qenë se jeni avokat.

Z.I. : Unë nuk e konsideroj fare ligj. Unë e quaj një turp kombëtar atë.

Gazetari: Kjo është tjetër gjë.

Z.I. : Po ligj nuk është se që të kesh një ligj do të thotë që ata diskriminohen ose goditen, ose janë të pambrojtur. Kush i ka sulmuar? Kush u ka thënë atyre se ç’bëjnë me trupin e tyre? Të bëjnë ç’farë të duan. Asnjë vlerë s’kanë për mua. Unë nuk i quaj njerëz në radhë të parë pjesëtarët e atij grupi. Po kush është ky që kërkon mbrojtjen e tyre? Dhe ç’është nevoja që Parlamenti dhe Qeveria, Presidenti të merren me LGBTQ-të dhe të mos merren me shkollimin e fëmijëve, të mos merren me kontrollin e shkollave, mos të merren me pastrimin e rrugëve dhe të qyteteve, të mos merren me pensionet, të mos merren me urinë dhe familje të syrgjynosura, të ngujuara, që nuk kanë bukën e vaktit për të ngrënë dhe merren me këta. Çfarë Parlamenti është ky mo? Ky është pocaqi, s’është parlament. Po këta vetëm deputetë nuk janë dhe vetëm përfaqësues të popullit nuk janë. Po këta kanë një të drejtë, se populli shqiptar flë, është në gjumë dhe një popull në gjumë vdes. Gjumi rrit fëmijë por vdes një popull. Pra, të më thotë i nderuari President, o zoti Bajram Begaj, më thuaj zotëri, ç’qe kjo nevojë ti të miratoje këtë ligj dhe nuk pate kurajë ti bëje një koment ose të kundërshtojë.....”

Gazetari: Tani, argumenti ka qenë ky profesor. Të paktën të gjithë ata që e ndiejnë veten ndryshe në orientimin seksual...”

Z.I. : Ta ndiejnë mo, kush i pengon. Të lutem edhe një herë se është një spekulim në këtë që thonë. E ndiejnë veten ndryshe. Ç’është kjo, e ndiejnë veten, ta ndiejë si të dojë, ç’më duhet mua. Unë skam punë me të.

Gazetari: Ju s’keni vlerësim fare për ta?

Z.I. : Absolutisht. Nuk i llogaris fare për qenie të gjalla, për njerëz.

Gazetari: Po si i llogarisni?

Z.I. : Bagëti, tutje....turmë amorfe.

Gazetari (duke qeshur): jo mos.....

Z.I. : Po po, më thuaj. Ku është kryetari i Kishës Ortodokse Shqiptare, ku është kryetari i Kishës Katolike Shqiptare, ku është Komiteti Mysliman Shqiptar. Ekzistojnë këta? Kjo që kanë miratuar, ky i famshmi Presidenti juaj, është në bazë të moralit njerëzor për qytetarë dhe fetar të të gjitha kohërave, me shoqërinë njerëzore? Pastaj, ç’është ky ligj, se ju thoni na e imponon Europa. Ç’punë ka Europa me neve?

Gazetari: Për sa kohë aspirojmë të jemi pjesë e saj.

Z.I. : More po nuk më detyron dot se nuk jam pjesë e saj, nuk jam pjesë e saj. Kur të bëhem pjesë e saj, po mund ta bëj atë gjë, po tani nuk jam. Atëherë çdo nga unë, ç’kërkon?....

Gazetari: E deformon familjen shqiptare profesor, pikërisht kjo?

Z.I. : E shkatërron, jo e deformon. A, meqë më dole tek familja, atëherë po ta them unë. Shqipëria është popull “kavje”, popull eksperimental i atyre, i “kabales”, “bilderbergëve”, “rokfelerëve”, “rotçillve”, që duan të shkatërrojnë popullin Shqiptar. E kanë filluar këtë në vitin 1945, kur sollën,

kur pushtuan Shqipërinë falangat e kuqe dhe po e vazhdojnë sot e kësaj dite, duke e shpërbërë dhe gjenetikut, duke i hequr edhe atë të drejtë hyjnore njerëzore, që të mbrojnë familjen, djalë, vajzë, motër, vëllanë, babë, nënë. Këto gjëra, këta duan t'i zhduk. Çdo me thënë barazi gjinore? Çfarë kanë pësuar mo, më thonë? Çfarë kanë pësuar, se nuk e kuptova këtë ligj unë.....Pse duhet bërë ligj dhe nga kush do mbrohen këta? Kush i sulmoi, kush i goditi, kush i vrau, kush i preu? Çfarë kanë? Dhe si është e mundur që një pakicë pederastësh të komandojnë dhe të bëjnë një ligj për tërë popullin.

Gazetari: Ta ruajmë etikën. Mos...

Z.I. : Etika është....Pse LGBT nuk është etikë... të lutem. LGBTQ, meqë janë katër germa, ti them një e nga një apo i thonë anglisht edhe ruajnë etikën. Mos të gënjejmë veten, të më thonë, ku e gjetën këtë të drejtë këta mor zotëri, që grup i caktuar, të importuar pjesa më e madhe, që na bënë në Tiranë edhe Paradë, këtu në Tiranë, të imponojnë kërkesat dhe atë mënyrë e tyre të jetesës një popull të tërë. Ku e gjetën këtë të drejtë. Sa veta janë, të dalin, dhe ç'punë ka Parlamenti që merret me ta, në një kohë që Parlamenti ka me dhjetra problem të mëdha.

Gazetari: Në fakt nuk dalin. Ndjesë që ju ndërpreva, se ne kemi ftuar disa për të pasur një diskutim normal në studio, nuk pranojnë të dalin.

Z.I. : Ç'kanë? Pyetja më e thjeshtë. Ja unë po i pyes: Ç'keni që turpëroheni të dilni, ju LGBTQ-të, ju të famshmit, të "persekutuarit", të "dhunuarit", të "damllosurit". Kush ju pengoi juve, se çdo bëni në krevat me partnerët tuaj. Çfarë kërkonin nga ne të tjerët? S'keni faj ju, fajin e kanë ata që bëjnë ligje për ju dhe janë edhe ata si ju, që bëjnë këto ligje. Dhe unë po i akuzoj këta parlamentarë që kanë votuar këtë ligj, bashkë me Presidentin. Janë që të gjithë si këta që kanë bërë ligjin.

Gazetari: Profesor të lutem. Të qëndrojmë brenda diskutimit me etikë. Tani çështja është këtu. Ju e konsideroni shkatërrim total për familjen, por kohët moderne këto sjellin. Thoni që edhe në pjesën e Europës apo kudo në botë është shkatërruar nocioni i familjes?

Z.I. : Po ç'më duhet mua se ç'kanë bërë në Europë? Shkoj unë te komshiu që ti them si e trajton gruan dhe fëmijën ai, nuk shkoj, se nuk e kam këtë të drejtë. Tani këta ç'punë kanë? More pse marrin nga Europa atë që është antikombëtare....

Gazetari: Po çfarë përfitojmë në këtë rast? Kjo është pyetja që ngrihet. Pse duhet të realizohet pikërisht ky ligj?

Z.I. : Atëherë po ta them. Në 1910, Rokfeler ka thënë kështu "Në do ti marrim, do të fusim në punë gratë e shoqërisë. Do punojnë gratë, do lindin fëmijët, fëmijët t'i rrisim nëpër çerdhe. Nëpër çerdhe do t'i edukojmë me parimet dhe kërkesat tona dhe në këtë mënyrë ne do të komandojmë shoqërinë njerëzore."

Gazetari: Do kemi shtresa punëtore, jo vetëm.

Z.I. : Në këtë mënyrë do të eliminojnë familjen dhe do të bëjnë një shoqëri kozmopolite, që të mos ketë ndjenja familjare, të mos ketë kërkesa për familjen. Dhe unë përshëndes nga studio juaj presidentin e Hungarisë Orban, i cili i kundërshtoi.

Gazetari (ndërhyn): E ka kundërshtuar në fakt.

Z. I. : Në mënyrë të prerë. Gjithashtu, para z.Orban, përshëndes presidentin Amerikan Donald Trump, i cili tha se në shoqërinë amerikane ka vetëm burrë dhe grua. Këta pederastët tanë tani ku do ti gjejnë burrat...këta që po miratojnë.

Gazetari ndërhyn: Të lutem shumë avokat.

Z.I. : Po, të lutem shumë. Se ju dhe më ftoni dhe më thoni mos fol.

Gazetari: Nuk them këtë, mos flisni...

Z.I. : Të flas brenda kornizave që vejnë këta. Pse do më vënë në kornizë mua? Se kornizën ma ka vënë me ligj të tillë anti njerëzor, anti human, anti moral, një ligj mizerabël, një ligj që nuk është ligj, dhe e bëjnë ligj. Merret Parlamenti me këto dhe nuk merret me problem të tjera.....

Gazetari: Profesor, po i kundërshtoni bindshëm, por me kalimin e këtij ligji, ju nesër mund të përballeni me persona të tillë, ndoshta mund ti keni edhe klientë të punës tuaj, mund të përballeni në institucione.

Z. I. : Po edhe? Si do të përballem, se kuptoj?

Gazetari: Cili do të ishte reagimi juaj? Po është krejt normale. Dikush mund të vij të marrë ndihmën tuaj profesionale ose shkoni në institucione dhe përballeni me një pjesëtar të tillë.

Z.I. : Në profesionin tim, kam gjënë më të lehtë, të kollajtë, që ti them, zotëri larg nga zyra ime, nuk ju shërbej njerëzve të tillë. Nuk kam qejf, nuk kam dëshirë. Bile të shoh nuk kam dëshirë, jo më të të shërbej. I thjeshtë. Më i thjeshtë nuk ka ku të shkojë.

Diskutimi vijon mbi nevojën për zhvillimin e konsultimeve dhe referendumeve.

Z. I. : Pra, popullit Shqiptar i është mbyllur goja me ligj. I thonë mos fol. Dhe unë këtë kundërshtojë me të madhe, diktaturën e vendosur.....O shqiptarë zgjohuni nga gjumi. Zgjohuni sepse po i detyrojnë fëmijët tuaj në shkollë të mësojnë seksin e kundërt, të mësojnë gjëra që nuk i takojnë për moshën që kanë, sidomos para pubertetit. Dhe unë do sjell në vëmendjen tuaj dhe qytetarëve shqiptar, faktin e asaj vajzës 14 vjeçe që i hoqën gjiret sepse gjasme sipas të ëmës ndihej si djalë. Ç'është kjo? Ç'është ky veprim makabër që kanë bërë dhe shëndetësia shqiptare nuk flet dhe ministria shqiptare nuk flet, dhe qeveria shqiptare nuk flet, por flasin për LGBTQ-të. Shyqyr i martoi Erion Veliaj. Veç një gjë. Ka një karma. Erion Veliaj martoi dy lesbike atje, dy buçe dhe ku përfundoi.

Gazetari (ndërhyn): Profesor të lutem.

Z.I. : Të lutem, po çfarë janë?

Gazetari: E ruajmë etikën. Nuk marr përsipër të mbroj palën, por duke qenë se hyjmë në grup mosha të ndryshme që na ndjekin, pra ndaj i referohem për etikën.

Z. I. . Më fal një minutë. A bëhet fjalë për grup mosha.

Gazetari: Jam shumë dakort dhe bashkohem me ju në shqetësimin që keni.

Z.I. : Atëherë këto grup mosha që ju shkon këto lloj mësimesh, kjo lloj edukate në shkollë, nga kush vete? A vete nga shteti, a vete nga ligjvënësi, a është bërë një ligj për këtë punës? Nuk bëjnë ligj për kthimin e pronave por bëjnë ligj për LGBTQ-të. Jeni njerëz të medias, hapni këto probleme.....

Gazetari: Profesor ne i kemi trajtuar edhe këto tema. Me kënaqësi mund t'ju ftoj. ...

Nëse keni një mesazh të fundit për të dhënë, për institucionet, për prindërit, për familjarët, për rastin e temës që diskutuam.

Z.I. : Dua tu them qytetarëve shqiptarë vetëm një fjalë, çohuni, mbroni të nesërmen e fëmijëve tuaj se po jua tjetërsojnë, po jua shkatërrojnë familjen dhe objektivi i “bilderbergëve”, “rotçillve” dhe “rokfelerëve” është zhdukja e familjes, është zhdukja e kombit shqiptar. Çohuni.

.....
Gjatë transmetimit të emisionit, me titra shfaqen në ekran : “Barazia gjinore”, *hyn në fuqi pa firmën e Presidentit*”, “Barazia gjinore/I. : Turp, s’duhet t’u japim rëndësi”, “Shqipëria e përdorur si “kavje” nga disa fuqi të huaja”, “Evropa s’mund të na imponojë të miratojmë ligje për LGBT”.

Në profilin e televizionit Report Tv në rrjetin social Facebook, janë publikuar pjesë nga diskutimi i mësipërm me përshkrimin “O Begaj.....pse e miratove ligjin për pederastët”, avokati thirrje presidentit: *Ke frikë nga Rama*”⁷. Emisioni i plotë është publikuar në kanalin zyrtar të televizionit Report Tv⁸.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 33/1/c të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, e cila i jep të drejtën Komisionerit që të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji, Komisioneri me urdhrin nr. 151, datë 17.12.2025, urdhëroi fillimin e procedurave hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me deklaratat e bëra në mediat e sipërcituara nga z. Z.I ndaj personave LGBTI.

Hapat procedurialë të ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e çështjes, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Me shkresën nr. 1808 prot., datë 24.12.2025, Komisioneri njoftoi z. Z.I , Televizionin Vizion Plus/Shoqërinë Media Vision sh.a dhe Televizionin Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, për fillimin e procedurës administrative dhe njëkohësisht kërkoi parashtrime në lidhje me çështjen.
2. Me shkresën nr. 105 prot., datë 30.12.2025 (administruar pranë Komisionerit me nr.24 prot., datë 06.01.2026, Televizionin Vizion Plus/Shoqërinë Media Vision sh.a, ktheu përgjigje, duke parashtruar ndër të tjera:

Vizion Plus, si operator mediatik i licencuar që vepron në republikën e Shqipërisë, respekton plotësisht dhe pa rezerva legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi. Vizion Plus njeh dhe respekton plotësisht mandatin kushtetues dhe ligjor të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si organ i pavarur që mbron të drejtat dhe liritë themelore të individëve nga çdo formë diskriminimi. Vizion Plus merr në konsideratë faktin se hetimi administrativ është nisur në bazë të nenit 32/1/c të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili i njeh Komisionerit të drejtën për të filluar hetim administrativ me iniciativën e tij, mbi bazën e informacionit të marrë.

Veprimtaria e Vizion Plus rregullohet kryesisht nga kuadri i posaçëm ligjor për mediat audiovizive, konkretisht: ligji nr.97/2013 “Për mediat Audiovizive në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i

⁷ <https://www.facebook.com/reel/1795022857839082>

⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=07-EFFwZxVI>

cili përcakton në mënyrë të detajuar detyrimet, standardet dhe përgjegjësitë e operatorëve audiovizivë”, si dhe Kodi i Transmetimit, i cili parashikon standardet etike dhe profesionale që duhet të respektohen në përmbajtjen e transmetuar.

Vizion Plus shpreh bindjen e plotë se nga hetimi administrativ do të rezultojë se shoqëria nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe se veprimtari e saj ka qenë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale dhe etike.

Natyra e emisionit.

Emisioni “Living Day” është një program informativ-debatues me karakter aktual, i cili trajton tema të ndryshme me interes publik, duke ftuar ekspertë, personalitete dhe figura publike për të shprehur qëndrimet e tyre. Format i emisionit është ai i debatit të lirë dhe të hapur, ku drejtuesi i emisionit paraqet pyetje me të drejtën kushtetuese për lirinë e shprehjes të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Roli dhe përgjegjësia e Vizion Plus

Të ftuarit shprehen në emër personal.

Z. Z.I ka qenë i ftuar në emisionin “Living Day” në cilësinë e tij personale si avokat dhe figurë publike, dhe jo si përfaqësues i Vizion Plus. Qëndrimet, mendimet dhe deklaratat e shprehura prej tij përfaqësojnë pikëpamjet e tij personale dhe jo qëndrimin zyrtar të shoqërisë “Media Vizion” sh.a

Detyra e operatorit audioviziv.

Sipas përcaktimeve të ligjit nr.97/2013, operatorët audiovizivë kanë për detyrë të sigurojnë: “Pluralizëm dhe diversitet në programacion, mundësi për shprehje të mendimeve të ndryshme dhe respektim të dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave themelore.”

Vizion Plus, si operator, ka respektuar këto parime duke ftuar në debat figura me pikëpamje të ndryshme, duke lejuar shprehjen e lirë të mendimit dhe duke ndërhyrë përmes drejtueses së emisionit për të moderuar diskutimin kur qëndrimet e të ftuarit janë konsideruar të forta dhe kontroverse.

Ndërhyrja e gazetares.

Siç rezulton edhe nga transkriptit të cituar në shkresën tuaj, drejtuesja e emisionit ka ndërhyrë në disa raste, për të:

- Relativizuar qëndrimet e z.I. ;
- Kërkuar përdorimin e termave të përshtatshëm (Të lutem, se jemi edhe në një orar ku na ndjek gjithë familja. kështu që duhet të jemi të kujdesshëm me termat”)
- Kundërshtuar deklaratat (“Avokat, nuk mendoni se liria juaj mbaron atje ku fillon liria e tjetrit?”, “Jeni duke i fyer, avokat”)

- tentuar të balancojë diskutimin.

Kjo tregon se Vizion Plus, përmes stafit të tij editorial, ka tentuar të ushtrojë një kontroll editorial mbi përmbajtjen e emisionit, brenda kufijve të ligjshëm të lirisë së shprehjes.

Liria e shprehjes përkundrejt gjuhës së urrejtjes.

Vizion Plus është plotësisht i vetëdijshëm për ekuilibrat delikat mes lirisë së shprehjes (neni 22 i Kushtetutës, neni 10 i KEDNJ) dhe mbrojtjes nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit (ligji nr.10221/2010)

Analiza ligjore e deklaratave.

Vizion Plus është i shqetësuar për tonet e përdorura nga z.I. në disa nga deklaratat e tij, veçanërisht: *“Unë dua t’i zhduk të tërë”*; *“Këta janë rendimente të shoqërisë. Duhet të zhduken. Jam vetë përgjegjës për atë që them.”* Megjithatë, shoqëria jonë dëshiron të vërë në dukje se:

Konteksti i diskutimit

Deklaratat janë bërë në kuadrin e një debati të nxehtë dhe polemik mbi ligjin e barazisë gjinore, dhe jo si një thirrje e drejtpërdrejtë për dhunë fizike. Z.I. ka argumentuar se diskutimet e tij janë të natyrës ideologjike dhe filozofike, duke kundërshtuar konceptin ligjor të martesave brenda të njëjtës gjini dhe jo duke thorrur për dhunë ndaj personave LGBT.

Kundërshtimi i gazetares.

Drejtuesja e emisionit ka kundërshtuar vazhdimisht këto deklarata (“Jo, të lutem”; “Avokat, nuk mendoni se liria juaj mbaron atje ku fillon liria e tjetrit?”; “jeni duke i fyer, avokat”), gjë që tregon se Vizion Plus, përmes stafit editorial, nuk i ka mbështetur dhe nuk i mbështet këto qëndrime.

Transmetimi live.

Emisionet e formatit *“talk show”* transmetohen shpesh në kohë reale (live), gjë që kufizon mundësinë e kontrollit editorial të plotë mbi çdo fjalë të shqiptuar nga të ftuarit. megjithatë, Vizion Plus ka mekanizma të brendshëm për të ndërhyrë në raste ekstreme.

Masat e marra pas emisionit.

Pas transmetimit të emisionit dhe reagimeve publike, Vizion Plus ka ndërmarrë këto masa:

Rishikimi i brendshëm.

Departamenti editorial dhe juridik i shoqërisë ka bërë një rishikim të plotë të emisionit për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe etike.

Rivendosja e politikave editoriale.

Vizion Plus ka rivendosur dhe forcuar politikat e saj editoriale për të siguruar që stafi editorial të jetë më proaktiv në modelimin e diskutimeve. Të ftuarit të njoftohen paraprakisht për standardet etike dhe ligjore dhe të ekzistojnë mekanizma të shpejtë për ndërprerjen e transmetimit në raste ekstreme.

Trajnimi i stafit.

Vizion Plus do të organizojë sesione trajnimi për stafin editorial dhe gazetarët për implementimin e ligjit “Për barazinë gjinore”, gjuhën e urrejtjes dhe standardet për evitimin e saj dhe menaxhimin e debateve të ndjeshme.

Në lidhje me publikimin në Facebook.

Vizion Plus njih se ka publikuar në profilin e tij në Facebook një video me përshkrimin : “Këta që martohen burrë me burrë dhe grua me grua duhet të zhduken, nuk përmbahet Z.I ”.

Qëllimi i publikimit.

Qëllimi i publikimit ka qenë të informojë audiencën për debatin e zhvilluar dhe të nxisë reagime dhe diskutime publike, në përputhje me misionin e medias për të promovuar debatin demokratik.

Titulli

Titulli përdor fjalët e sakta të shqiptuara nga z.I. dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Vizion Plus, por thjesht raporton deklaratën e bërë.

Masat e marra

Pas vlerësimit të reagimeve dhe për të shmangur keqkuptimet, Vizion Plus ka hequr postimin nga Facebook dhe ka vendosur të mos promovojë më tej përmbajtje në kanalet e saj dixhitale.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se mediat nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për çdo fjalë të shqiptuar nga të ftuarit, veçanërisht kur: Transmetimet janë live; Drejtuesi i emisionit ka ndërhyrë për të moderuar; Operatori ka marrë masa pas emisionit.

Dallimet mes qëndrimeve personale dhe gjuhës së urrejtjes.

Vizion plus njih se ekziston një vijë e hollë mes, shprehjes së mendimeve personale (edhe kontroverse) dhe gjuhës së urrejtjes që nxit diskriminim ose dhunë. Shoqëria është e angazhuar të respektojë këtë ekuilibër duke lejuar shprehjen e lirë të mendimit, parandaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe duke ndërhyrë kur debati kalon kufijtë e lejuar ligjorë.

Përgjegjësia personale e z.Z.I .

Vizion plus dëshiron të theksojë se z.Z.I mban përgjegjësi personale për deklaratat e tij, si person privat dhe figurë publike. Sipas Kodit Penal, nxitja e urrejtjes përbën vepër penale, dhe ndjekja penale është në kompetencë të organeve të drejtësisë penale. Nëse Komisioneri vlerëson se deklaratat e z.I. përbëjnë shkelje ligjore, përgjegjësia bie mbi atë si autor i deklaratave, dhe jo mbi Vizion Plus si media.

Angazhimet e Vizion Plus.

Kodi Etik Editorial

Vizion Plus zbaton një Kod Etik Editorial që përfshin: Respektim i të vërtetës dhe saktësisë, paanësi dhe objektivitet, respektim i dinjitetit dhe privatësisë, mbrojtje e të miturve, balancim i burimeve gazetareske dhe kryesisht shmangie e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.

Mekanizmat e kontrollit editorial.

Vizion Plus ka vendosur mekanizma të brendshëm për të garantuar cilësinë dhe konformitetin ligjor:

Para transmetimit kryhet *briefing* i të ftuarve me standardet etike, përzgjedhje e kujdesshme e termave dhe të ftuarve dhe trajnim i gazetarëve.

Gjatë transmetimit kryhet monitorim i vazhdueshëm nga regjia, ndërhyrje e drejtuesit të emisionit dhe mundësi eventuale për *delay* ose ndërprerje në raste ekstreme.

Pas transmetimit kryhet rishikim i përmbajtjes, vlerësim i reagimeve dhe merren masa korrigjuese kur është e nevojshme.

Programimi i trajnimit të stafit.

Vizion Plus do të nisë një Program të thelluar dhe të përforcuar trajnimi që përfshin njohuri mbi ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 dhe zbatim praktik i tij, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, gjuha e urrejtjes dhe identifikimi dhe parandalimi tyre. Moderimi i debateve të ndjeshme, menaxhimi i krizave mediatike, etika gazetareske dhe përgjegjësia sociale. Trajnimi do të jetë i detyrueshëm për të gjithë stafin editorial dhe do të përsëritet periodikisht.

Vizion Plus e konsideron këtë proces si një mundësi për të rishikuar, reflektuar dhe përmirësuar praktikën e tij, duke forcuar angazhimin për një media të përgjegjshme, profesionale dhe në shërbim të interesit publik.

3. Në datë 14.01.2026, ktheu përgjigje z. Z.I (administruar pranë Komisionerit me nr.123 prot., datë 14.01.2026, duke parashtruar ndër të tjera:

Duke qenë besnik bindjeve të mia tradicionale kombëtare lidhur me familjen dhe rolin e saj në shoqëri si qelizë elementare e formimit të një kombi dhe mbështetur në edukimin tim familjar e

kulturor me ndikime edhe nga korifejtë e filozofisë, edukimit, letërsisë, sikurse shkrimtari më i madh e më i lexuar francez, Honore dë Balzak, që konsiderohet si një nga mendjet më të ndritura të botës së letrave i cili shprehet: “Familja gjithmonë do të mbetet themeli i shoqërisë”, gjithmon kam shprehur dhe mbrojtur vlerat që ajo mbart qysh nga krijimi i botës, sikurse janë vlerat kombëtare, humane, kulturore etj dhe gjithmonë i jam bashkuar kauzës për t’i ruajtur, mbrojtur e transmetuar ato.

Kohët e fundit, shoqëria jonë përballët me një presion masiv të ardhur nga jashtë vendit, pa qenë nevojë e brendshme, tej traditës dhe mendësisë kombëtare, me atë të krijimit e sajimit artificial të një minoriteti homoseksualësh apo grupim të tyre që përmban në vetvete një diskriminim dhe agresivitet të këtyre pak njerëzve, përballë shumicës së popullsisë tonë tradicionale.

Duke besuar në faktin se familja në përgjithësi dhe ajo shqiptare në veçanti, është një strukturë sociale, shpirtërore, etike, morale, reproduktive, edukative dhe marrëdhënie personale kolektive, të rregulluara brenda saj, si themel i shoqërisë, me një hierarki e autoritet të pakontestueshëm të Kryefamiljarit (njohur e pasqyruar ky titull nga institucionet shtetërore si gjendja civile etj), nuk nguroj të shpreh publikisht mendimin tim të lirë ndaj çdo shkatërruesi të themelit të shoqërisë, të kombit dhe të vendit dhe është e drejta ime që të kem kundërshtime ndaj pozicionimit dhe çfaqjeve të një aspakice sa gishtat e një dore, të cilët kërkojnë shkatërrimin e këtyre vlerave të urdhëruara nga Zoti si krijues dhe organizues i gjithë Universit, urdhëruar dhe pranuar nga të gjitha fetë në të gjithë botën gjeografike, duke filluar që nga Europa, Amerika, Kanadaja, Australia dhe deri në Japoni.

Është fakt evident i vërtetuar edhe arkeologjikisht se si e ndëshkoi Zoti për mosbindje për t’u larguar nga perversiteti homoseksual, popullsinë e Somorrës dhe Gomorrës, dy qytete pranë detit të vdekur nëpërmjet çarjes së tokës dhe fundosjes në thellësinë 400 m nën nivelin e detit të të gjithë gjynahqarëve, duke përjashtuar vetëm familjen e kundërshtuesit të këtyre fenomeneve që zvetënuan vlerat morale të familjes.

Duke besuar në vlerat humane të lirisë së mendimit dhe shprehjes që burojnë nga legjislacioni shqiptar e kushtetues, ashtu edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila prevalon mbi ligjshmërinë vendase për shkak të ratifikimit të saj nga shteti ynë, që tashmë është burim i së drejtës, e shprehur në nenin 9 dhe 10 të saj, unë shpreh haptazi dhe pa ngurrim se jam kundër ndërhyrjes së shtetit dhe marrjen në mbrojtje të panevojshme të atyre pak individëve të pacenuar në liritë dhe të drejtat qytetare që gëzon çdo shtetas në Republikën e Shqipërisë, pa qenë nevoja për një trajtim special të njëanshëm dhe favorizues. Në rastin konkret, as më shumë dhe as më pak, unë kam shprehur vetëm mendimin tim të lirë, i cili është në harmoni e koherencë të plotë me Kushtetutën e vendit.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës, vendi ynë është në *zgrip* të ekzistencës ku, për shkak të politikave ekonomiko-sociale të ndjekura nga qeveritë e këtyre 35 viteve, largimi masiv dhe ndarja në dy pjesë e familjes midis shteteve të ndryshme ku emigrohet nga njëra anë dhe, vendit tonë nga ana tjetër, ku hemoragjia e largimit vazhdon në progresion gjeometrik, krahasuar me numërimin e

martesave dhe lindjet natyrale, e bën imperativ mbrojtjen e familjes si institucion dhe ndërhyrjen urgjente të shtetit për mbrojtjen e saj.

Pra, ndërhyrja e institucioneve për mbrojtjen e interesit të gjerë publik, prevalon mbi gjithçka, për më tepër, prevalon ndaj interesave absurde të pak individëve që nuk përbëjnë as grup e as pakicë.

Për këtë shkak, jo vetëm që nuk duhet diskutuar e favorizuar dalja në pah e këtyre deviacioneve antivlerë, por duhet bërë kufizimi me ligj i disa kërkesave të pamotivuara të disa individëve UFO ose numërpaktë të LGBTQI, të dalë nga normaliteti dhe të denatyrizuar që i imponohen shoqërisë pa u marrë askush me parapëlqimet e tyre intime në qoshkat e tyre; për të përballuar këtë agresion familja, shoqëria, fëmijët, adoleshentët, rinia, duhen mbrojtur e forcuar në përpjestim me gjendjen aktuale alarmante të rrezikut të shuarjes së shpejtë të kombit tonë.

Ajo që e bën alarmante ruajtjen e këtyre vlerave të familjes dhe të kombit është fakti që, krahasuar me popullsinë e mbetur e të tejplakur aktualisht në vendin tonë, po ndryshojnë në mënyrë dramatike raportet demografike në favor të tjetërsimit të popullit e të kombit tonë duke krijuar premisa për t'u kthyer në pakicë brenda vendit tonë.

Në referencë të nenit 18, të Kushtetutës së Republikës, me këtë njoftim që më drejton institucioni juaj, lidhur me prononcimet e mia në median elektronike për të ruajtur vlerat e familjes së rrezikuar totalisht nga marrja nën mbrojtje e këtyre pak individëve që, as grupim e as pakicë nuk mund të quhen, pasi ata refuzohen edhe nga vet familja e tyre, madje madje, sjell në vëmendjen tuaj se unë dhe të gjithë bashkëkombasit e mi po diskriminohemi në vendin tonë, në punën tonë, në familjet tona nga ata pak persona pa origjinë, të importuar nga nuk e di se ku, të cilët janë të parrezikuar prej askujt.

Ata, në mënyrë të padrejtë e të parrezikuar nga askush, pasi nuk ekziston asnjë mohim i ndonjë të drejte të tyre si e drejta e punësimit, arsimimit, trajtimit mjekësor, strehimit, shprehjes së mendimit të lirë etj, kërkojnë të hyjnë pa trokitur në jetët tona, në përditshmërinë tonë, edhe pse ne jemi indiferentë ndaj tyre dhe nuk përzihemi në preferencat e tyre seksuale.

Lidhur me prononcimet e mia nëpër media, unë thjesht kam shprehur mendimin tim të lirë për të mos institucionalizuar kërkesat e tyre absurde, por të vazhdojnë jetën e tyre në shtretërit e tyre, sikundër mund të jetë vepruar prej tyre në shekuj.

Jo çdo shfaqje përbën vlerë dhe jo çdo shfaqje duhet institucionalizuar. Është e pamotivuar hipokrizia dhe servilizmi i politikës dhe i institucioneve tona për të krijuar një pakicë inekzistente në kuptimin e minoritetit, pa qenë nevojë, vetëm e vetëm për konformizëm ndaj qarqeve të errëta që na e imponojnë këtë të ashtuquajtur komunitet për ta përdorur si *password* të hyrjes tonë në Bashkimin Europian.

Në pranimi i vendit tonë në BE, është i kushtëzuar nga kjo kërkesë bizarre e 10 individëve, ne nuk e duam pranimin në BE me të tillë kosto, ndërkohë që shumë vende të BE janë kundërshtues të vendosur të kësaj urdhërese absurde e të papranueshme nga masa dërmuese e popullsisë.

Nuk mund të akuzohet shoqëria shqiptare për mostolerancë pasi jeton normal me praninë e pakicave kombëtare, madje mund të thuhet se është vendi model edhe për tolerancën fetare e sociale, fak i vërtetuar nga ekzistenca e tre feve dhe e pakicës së egjiptianëve e ciganëve me mijëra vjet, ku askujt nuk i është mohuar asnjë e drejtë e garantuar nga Kushtetuta jonë në nenin 18 të saj.

Përderisa këta pak individë nuk kanë asnjë arsye për t'u diferencuar me ligj të veçantë favorizues në kurriz të vlerave të familjes dhe ekzistencës së kombit që sot është në zgrip, krahasuar me grupet e tjera sociale sikurse pensionistët, invalidët, peshkatarët, gjahtarët, romët, komuniteti egjiptian, përse duhet të fryhen kaq artificialisht saqë të dalë me flamurin e tyre në paradën e “krenarisë” vet Ministria e Shëndetësisë, që është një personalitet me integritet të lartë e profil të ulët, por që u vu para presionit se, nëse nuk u paraprin në këtë paradë “krenarie” pa krenari këtyre pak individëve të mbledhur nga askundi, do të kryqëzohej nga autoritetet vendase e ato të BE, apo duhet të bëhej e pëlqyeshme përpara tyre, ndërkohë që janë evidente problemet e trashëguara në ministrinë që ajo drejton sa i takon mungesës së medikamenteve jetike për të sëmurët me probleme onkologjike, është evidente diskriminimi i moshës së tretë për personat mbi 70 vjeç në ndërprejen e *çekap-it* vjetor pas kësaj moshe me kontribute jo të pakta në ekonominë e vendit prej mëse 40 vjetësh në veprat madhore si hapja e rrugëve, bërja e hidrocentraleve, minatorëve, hekurudhave, etj.

Pranimi pa kushte në shoqërinë tonë, i këtyre individëve edhe në atë ballkanike apo edhe europiane, është i pasinqertë, i panevojshëm, madje hipokrit, gjë që vërtetohet edhe nga mënyra tinzare e kalimit të ligjeve në favor të këtyre pak individëve, pa iu nënshtruar një diskutimi mbarë popullor.

Kjo hipokrizi duket qartazi në pjesmarrjen pothuaj bosh të sallës së Kuvendit të Shqipërisë lidhur me këto qasje, apo në intervista të deputetëve përpara mediave që ngërdheshen me buzëqeshje të sforcuar.

Duke e trajtuar problemin në të kundërt, meqënëse një individ ndjehet pederast, shoqëria duhet t'i nënshtrohet kësaj pjese kriminale në kurriz të fëmijëve të abuzuar, vetëm e vetëm që të quhet e pranueshme për përfaqësuesin e BE në vendin tonë se, na u diskriminuakan një numër fare i pakët individësh që nuk i mbroka dot shteti në atë se si ndjehen? Po këto viktima abuzimi si ndjehen?

Kjo qasje e gabuar e institucioneve është diskriminim i shumicës përballë pak individëve kudoqofshin ata.

Kodi i nderit e i moralit në shoqërinë shqiptare është një vlerë që duhet mbrojtur me fanatizëm kundrejt këtij sulmi bizarr të panevojshëm, pasi ai ka ruajtur kombin të bashkuar dhe familjen të shëndoshë dhe nuk mund të jem aq hipokrit me veten time dhe me bashkëkombasit e mi që këtë agresion të pak individëve ndaj pjesës së plotë të shoqërisë e të familjes tonë ta quaj vlerë dhe kulturë.

Unë kam parimin tim që të mbroj atë që është e drejtë përpara vetes time, familjes time, familjes shqiptare, përpara Kombit dhe Zotit dhe jo të mbroj atë që është e drejtë në sytë e botës perëndimore, “moderne”.

Unë i përkas në formimin tim pjesës së William Penn, themeluesit të Pensilvanisë: “E drejta është e drejtë edhe nëse të gjithë janë kundër.” “E gabuara është e gabuar edhe nëse të gjithë janë pro saj.”

Nuk vjen civilizimi dhe kultura e një populli nga dukuri anormale të pak individëve të lënë në parapëlqimet e tyre, pasi ky ekstrem social i imponuar e i importuar, nuk lidhet me traditën tonë kombëtare; ai do të mbetet një çiban i huaj në trupin e shëndoshë të familjes shqiptare.

Faktori politik dhe ai i huaj në Shqipëri nuk mund t’i mbushin mendjen shoqërisë shqiptare se kauza e homoseksualëve është e drejtë. Ajo është një kauzë e njerëzve që nuk janë seksualisht normal, që nuk janë në mënyrë morale normal, që nuk veprojnë nga ana sociale si njerëz normalë.

Institucionet shtetërore, përpara se të na imponojnë këta pak individë që të pranohen si vlerë, më parë, duhet që të trajtojnë nga ana shëndetësore këtë anomali të mosekuilibrit hormonal.

Nëse unë ndjehem Gjergj Kastrioti Skënderbeu apo Jezu Krishti, nuk është detyrë e shtetit që të investohet juridikisht se si ndjehem unë. Dhe unë nuk mund të agresohem ndaj pjesës tjetër të popullsisë vetëm e vetëm që të më pranojnë si të tillë dhe as të krenohem nëpër parada bizarre përkrah ministrave për vanitete shoqërore e morale.

Nisur nga fakti që pjesa më e madhe e këtyre individëve kanë përfituar këtë parapëlqim intim për shkak të incestit, të përdhunimit që në moshë minore apo në shërbimin ushtarak, janë potencialisht të mundshëm që të jenë bartës të sëmundjeve afrodiziake ose Sida dhe si të tillë duhet të trajtohen me kujdes të veçantë shëndetësor dhe jo të na imponohen agresivisht si vlerë kulturore e meritë krenarie.

Sipas sondazhit mbarëkombëtar të kryer në vitin 2022 në përputhje me pyetësin e shpërndarë nga IDAHOT, gjenerata e re e refuzoi pranimin e LGBTQI në masë më të madhe se gjenerata e vjetër, çka flet qartazi për pranueshmërinë e kësaj pakice individësh në shoqërinë tonë.

Futja e hundëve të bashkisë më të madhe të vendit deri në martesat e dy lezbikeve brenda mjediseve të saj, vendosja e flamurit shumëngjyrësh krahas flamurit kombëtar që përfaqëson gjakun shekullor të luftëtarëve tanë për liri në breza, është diskriminim e agresion i këtyre pak njerëzve ndaj të gjithë qytetarëve dhe vlerave kombëtare.

Pse bashkia p.sh nuk vendos para mjediseve të saj apo në qytet flamuj të organizatave të ndryshme atdhetare, por vetëm të atyre? Pse p.sh Ministria e Shëndetësisë nuk parakalon me të sëmurët me tumore ose sëmundje të tjera të rënda, po parakalon me këta njerëz të mbledhur nga vende të ndryshme të botës në vendin tonë duke provokuar ndjenjat e popullsisë vendase, ndërkohë që ata askush nuk i provokon por i toleron me indiferentizëm e pa vëmendje të veçantë?

Pse psh Ministria e Shëndetësisë nuk parakalon me fëmijët ciganë të grumbulluar nga rrugët që lypin e janë viktimë e familjeve ose tutorëve të ndryshëm, që u privohet veshja, strehimi, ushqimi, arsimi dhe përse ju si institucion nuk investoheni dhe në mosdiskriminimin e tyre përballë fëmijëve të tjerë?

Unë nuk kam asnjë fuqi vendimarrëse institucionale dhe as kam refuzuar dhënien e të drejtave të tyre të barabarta përpara ligjit në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, dhe as kam penguar që ata si gjithë të tjerët, të gëzojnë çdo të drejtë, pa trajtime ekstra, preferenciale.

Edhe vetë Europa imponuese ndaj qytetarëve tanë për të pranuar si minoritet kulturor këta pak individë me qasje anormale seksuale, nuk ka mundur të shmangë refuzimin që u bëjnë shtetasit e tyre si psh. Hungaria, Zvicra etj, ndërkohë që nga studimet dhe sondazhet në qarqet studentore, ukrainasit ishin në përqindje të lartë, po ashtu italianët ishin refuzues po aq sa edhe studentët shqiptarë.

Shumë intelektualë të tjerë në vendin tonë, madje edhe pedagogë universitetesh apo përfaqësues subjektsh politike e grupimesh të tjera, janë haptaz refuzues ndaj këtyre individëve të paktë, por institucioni juaj nuk është investuar, duke treguar haptaz anësi. Institucioni juaj, në dijeninë time nuk është bërë pjesë e diskutimeve mbarëpopullore dhe investimeve në media lidhur me këtë qasje të këtyre individëve, ndërkohë që është i gatshëm që të investohet me nisje të hetimit administrativ për personin tim që me krenari të lidhshme jam haptazi në favor të vlerave të familjes dhe të traditës tonë kombëtare.

Në përfundim të sa më sipër dhe në refuzim të ndërmarrjes së institucionit tuaj për t'u investuar në adresën time, të interpretuar si sjellje diskriminuese, e konsideroj dhe kërkoj të mos quhen sjellje diskriminuese e sulm ndaj këtyre individëve LGBTQI prononcimet dhe qasjet e mia për parapëlqimet e tyre seksuale të patrazuar prej askujt në privatësinë e tyre. Përkundrazi, ata dhe institucionet e arsimit e të shëndetësisë u krijojnë akses edhe nëpër shkolla tek të kiturit që të edukohen dhe të influencohen nga këto çrregullime të denatyrizuara, për të cilat prindërit e fëmijëve të shkollës janë bërë barrikadë e fortë ndaj tendencës për të hyrë brenda shkollës e për të shpërndarë literaturë me përmbajtje LGBTQI si dhe familjarizimin e fëmijëve me termat bizarrë Prindi 1 dhe Prindi 2.

Në mbyllje, sjell në vëmendjen tuaj se Presidenti i Kështjellës Botërore të Demokracisë, Donald Trump urdhëroi njohjen vetëm të dy gjinive femër-mashkull dhe ruajtjen e mbrojtjen e familjes nga qasje të tjera.

Sikundër e kam theksuar në të gjithë materialin objekt kundërshtimi, qasja ime për ruajtjen e familjes, moralit dhe traditës tonë kombëtare, është koherente me tërësinë e popullsisë tonë, përkundrazi, thirrja ime për të dalë përpara institucionit tuaj dhe fillimi kryesisht i procedurave hetimore për ndjekjen e çështjes, janë diskriminim i hapur që më bëhet mua dhe të gjithë shumicës dërrmuese të popullsisë që shprehen pro pozicionimit dhe prononcimit tim mediatik lidhur me këtë çështje.

Për sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe nenin 9 e 10 të KEDNJ për lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit (neni 9-Liria e ndërgjegjes dhe e fesë), kërkoj ndërprerjen e këtij hetimi administrativ jo të drejtë dhe moskonstatimin e diskriminimit nga ana ime për këta pak individë, të cilëve nuk u është shkelur asnjë e drejtë e garantuar nga dispozitat ligjore të referuara më sipër.

4. Me shkresën nr.0435 prot., datë 6.3.2026 (administruar pranë Komisionerit me nr. 469/1 prot., datë 09.03.2026), ktheu përgjigje Televizionin Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duke parashtruar ndër të tjera:

Emisioni në fjalë është transmetuar në format live. Gjatë diskutimit, një nga të ftuarit ka përdorur shprehje fyese të papërshtatshme ndaj komunitetit LGBTI. Këto deklarime kanë qenë qëndrime individuale të të ftuarit dhe nuk përfaqësojnë në asnjë formë qëndrimin editorial të Televizionit Report TV apo të shoqërisë MTSC sh.p.k.

Moderatori i emisionit ka reaguar menjëherë gjatë transmetimit duke i tërhequr vëmendjen të ftuarit dhe duke tentuar ta ndërpresë përdorimin e gjuhës së papërshtatshme. Megjithatë, duke qenë natyra *live* e transmetimit, ndërhyrja ka qenë në kohë reale dhe brenda mundësive të kontrollit editorial në ato rrethana.

Theksojmë se subjekti ynë mediatik nuk promovon, mbështet dhe nuk toleron gjuhë diskriminuese apo nxitëse ndaj asnjë individi apo grupi shoqëror, përfshirë komunitetin LGBTI.

Për këtë ngjarje Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka shqyrtuar rastin dhe ka vendosur masë administrative ndaj subjektit tonë, masë e cila është zbatuar nga ana jonë.

- Për këtë ngjarje janë marrë masat konkrete për:
- Heqjen nga portalet dhe rrjetet sociale të Report Tv dhe Shqiptarja.com të të gjithë materialit që lidhet me rastin në fjalë;
- Rikonfirmimin e standardeve editoriale dhe etike për moderatorët dhe stafin;
- Rritjen e kujdesit në menaxhimin e debateve live;
- Dhënien e udhëzimeve të brendshme për ndërhyrje më të menjëhershme dhe më të prerë në rastet e përdorimit të gjuhës diskriminuese;

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.

2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 9

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 17

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Protokolli Nr. 12

Neni 1

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 2

1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

Neni 5

1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.

Neni 18

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.

2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.

3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.

4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Neni 19

1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.

2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.

3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 20

1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohet me ligj.
2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj.

Neni 26

Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër.

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

Neni 10

Ndërgjegjja dhe feja

1. Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

2. Përgjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përgjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminimin. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁹.

Neni 32

⁹ Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar).

Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove

4. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk transmetojnë programe me përmbajtje që:

a) nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtar të një grupi mbi baza të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinionimi politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha apo orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

Neni 33

Detyrimet e OSHMA-ve

1.Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet:

.....

ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;

Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive, miratuar me vendimin nr.60, datë 10.07.2023, të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)

Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikat e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore....

Përkufizime

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime në Kodin e Transmetimit:

9. “Gjuha e urrejtjes” është çdo lloj shprehje, që nxit, promovon, përhap ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuar, bazuar në: racë, ngjyrë, gjuhë, besim, kombësi, origjinë kombëtare ose etnike, përkatësi shoqërore, moshë, paaftësi, gjini, identitet gjinor, orientim seksual si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

28. “Shprehja” përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. “Shprehja” përfshin gjithashtu edhe përdorimin

e sjelljes - si p.sh. gjesteve - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim apo formave të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

Seksioni 1

Parimet Themelore

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audio dhe audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe pluralizmit të mjeteve të komunikimit audio dhe audioviziv janë si më poshtë vijon:

1.1 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre respektojnë, garantojnë dhe promovojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

1.6 Në transmetimet audio dhe audiovizive nuk duhet të përdoren shprehje, që përmbajnë gjuhë urrejtje, denigrim ose stigmatizim kundër një personi ose grupi personash, nuk duhet të përdoret gjuhë që promovon, nxit ose justifikon dhunën ndërmjet shtetasve në përgjithësi, dhunën me bazë gjinore në veçanti, radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin ose që nxit urrejtjen e grindjet për shkak të kombësisë, etnisë, besimit fetar, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual. Në transmetimet audio dhe audiovizive duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar, kundërvepruar, kundërshtuar dhe hedhur poshtë çdo shprehje të tillë.

Seksioni 7

Parandalimi dhe Luftimi i Gjuhës së Urrejtjes

7.1 OSHMA-të respektojnë dhe promovojnë diversitetin, dialogun, respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin mbarëshoqëror.

7.2 Materiali që përmban gjuhë urrejtjeje nuk përfshihet në programet audio dhe audiovizive. Rastet përjashtimore përcaktohen prej kontekstit profesional.

7.4 Gazetarët dhe drejtuesit e programeve audio dhe audiovizive, të prodhuara nga OSHMA-të, nuk duhet të përfshihen në retorika, që fyejnë ose denigrojnë individë për shkak të gjinisë, moshës, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, origjinës kombëtare ose etnike, aftësisë së kufizuar, identitetit gjinor ose orientimit seksual.

7.5 Gazetarët dhe drejtuesit e programeve audio dhe audiovizive, të prodhuara nga OSHMA-të, kundërshtojnë dhe hedhin poshtë retorikën e të ftuarve apo pjesëmarrësve, që fyejnë ose denigrojnë individë të ftuar apo pjesëmarrës sipas karakteristikave të përshkruara në paragrafin 7.4.

7.9 OSHMA-të ndalojnë shpërdorimin e programeve audio dhe audiovizive nga personat që nxisin urrejtje, dhunë raciste, ksenofobe, homofobe/transfobe, radikaliste dhe ekstremiste, që promovojnë pikëpamje ekstremiste apo gjuhë urrejtjeje.

7.10 OSHMA-të parandalojnë dhe ndalojnë stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin e grupeve shoqërore të caktuara.

7.13 OSHMA-të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kontestuar natyrën e papranueshme të saj, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit.

7.14 OSHMA-të krijojnë mekanizmat vetërregullatorë, rishikojnë kodet e sjelljes dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme për të adresuar parandalimi e gjuhës së urrejtjes gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre.

7.16 OSHMA-të mundësojnë kanale efektive të raportimit të gjuhës së urrejtjes dhe monitorojnë së brendshmi përdorimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Në rast të konstatimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë veprimtarisë audio/ audiovizive, ato duhet të reagojnë, ta dënojnë atë dhe të promovojnë vlerat dhe parimet.

Akte dhe dokumenta të tjerë në kuadër të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara

Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave)

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimin e nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Ministrave,

Duke ditur se lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin, marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave;

.....

Duke pasur parasysh se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë “Gjykata”) dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë;

.....

Duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur;

.....

Duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare, dhe as rregullat e një "kulture dominuese" nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor;

U rekomandon shteteve anëtare:

I. E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna

B. "Fjalimet e urrejtjes"

6. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. "Fjalimet e urrejtjes" ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe me jurisprudencën e Gjykatës.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t "Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes", miratuar më 8 Dhjetor 2015

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës", ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

....

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

.....

U rekomandon qeverive të Shteteve anëtare që:

7. të përdorin fuqitë rregullatorë në drejtim të medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

c. të inkurajojnë monitorimin dhe dënimin e përdorimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtjes;

d. të inkurajojnë, kur është e nevojshme, vendosjen e kufizimeve ndaj përmbajtjes, programeve të filtrimit të fjalëve dhe teknikave të tjera të këtij lloji;

e. të stimulojnë trajnimin e përshtatshëm për redaktorët, gazetarët dhe personave të tjerë që punojnë në sektorin e medias mbi natyrën e gjuhës së urrejtjes dhe si mund të dekurajohet përdorimi i saj;

.....

8. të specifikojnë fushën e veprimit dhe zbatueshmërinë e përgjegjësisë sipas të drejtës civile dhe administrative në rastin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes që synon apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

a. të përcaktojnë përgjegjësitë e veçanta të autorëve të gjuhës së urrejtjes, të ofruesve të shërbimit të internetit, të forumeve online dhe shërbimeve të hostimit, të ndërmjetësve online, të platformave të mediave sociale, të moderatorëve të blogjeve dhe të subjekteve të tjera që zhvillojnë role të ngjashme;

b. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohet fshirja e gjuhës së urrejtjes nga përmbajtja në internet dhe të bllokohen faqet e internetit që përdorin gjuhën e urrejtjes;

c. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohen publikuesit e medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe platformat e medias sociale) që të publikojnë një lajmërim ku pranojnë se një material i publikuar prej tyre përbënte gjuhë të urrejtjes;

.....

Sipas relacionit shpjegues që shoqëron Rekomandimin, parashikohet:

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a. "avokim" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;

i. "identiteti gjinor" nënkupton e përvojën e brendshme dhe individuale të gjinisë që çdo person ndjen së brendshmi, që mund të mos korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, përfshirë ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes apo funksionit trupor me mënyra mjekësore, kirurgjikale, apo të tjera) si dhe forma të tjera të shprehjes së gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe manierizmat;

g. "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;

m. "urrejtje" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllefi, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.

o. "homofobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga homoseksualiteti apo nga njerëzit që identifikohen apo perceptohen si biseksualë, homoseksualë, lesbikë apo transgjinorë;

q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;

u. “stereotipizim negativ” nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;

z. “orientim seksual” nënkupton kapacitetin e kujt do për tërheqje të thellë emocionale, simpatie dhe seksuale ndaj të tjerëve si dhe marrëdhëniet intime dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër apo të së njëjtës gjinie apo të më shumë se një gjinie

bb. “stigmatizim” nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;

cc. “transfobi” nënkupton paragjykimet, urrejtjes apo frikën nga transeksualiteti apo personat transeksuale apo transgjinnorë, bazuar në shprehjen e identitetit të brendshëm gjinnor të tyre;

gg. “grupe vulnerabël” nënkupton ato grupe që janë veçanërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë sipas rrethanave kombëtare por që zakonisht janë azilkërkuesit dhe refugjatët, emigrantët dhe migrantët e tjerë, komuniteti i personave me ngjyrë dhe hebrenjve, myslimanët, romët / ciganët, pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore, si edhe personat LGBT; në veçanti, përfshin fëmijët dhe të rinjtë që u përkasin grupeve të tilla;

- **Rekomandimi KM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022, në sesionin e 132):**

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës, Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

1. të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e shpejtë dhe të plotë të parimeve dhe udhëzimeve që i bashkëlidhen këtij rekomandimi;

Shtojca e Rekomandimit CM/Rec(2022)16

Për qëllimet e këtij rekomandimi, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për të karakteristikës ose statusit real ose që i atribuohet, të tilla si “raca”, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, gjinia, identiteti gjinnor dhe orientimi seksual.

Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

Media dhe gazetarët, në përpjekjet e tyre për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm, duhet të shmangin përkrahimin stereotip poshtërues të individëve, grupeve dhe komuniteteve dhe t'u japin zë grupeve dhe komuniteteve të ndryshme në shoqëri, veçanërisht kur raportojnë për çështje me interes të veçantë publik dhe gjatë periudhave zgjedhore. Ata duhet të shmangin provokimin e paragjyqimeve dhe të bëjnë referencë të panevojshme për karakteristikat ose statusin personal.

Rekomandimi Nr. 17 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Mbi parandalimin dhe luftimin e intolerancës dhe diskriminimit kundër personave LGBTI”, miratuar më 28 qershor 2023.

- Rritja e fjalimeve të urrejtjes anti-LGBTI dhe fushatave të ashtuquajtura anti-gjinore.

40. Në vitet e fundit, disa shtete anëtare kanë parë një rritje të diskursit politik dhe publik, veçanërisht në internet, kundër të ashtuquajturës "ideologji LGBTI" ose "ideologji gjinore". Lëvizjet "anti-gjinore" që kundërshtojnë të drejtat LGBTI shpesh kundërshtojnë edhe fushatat për të drejtat e grave, duke përfshirë edhe autonomi më të madhe riprodhuese. Ato shpesh bazohen në pretendime të pambështetura se mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të grave dhe të drejtave të personave LGBTI “minon identitetin kombëtar, lirinë fetare dhe vlerat tradicionale familjare”.

Retorika anti-gjinore dhe anti-LGBTI gjithashtu mund të paraqesë gabimisht të drejtat e njeriut të personave LGBTI, veçanërisht personave transgjinorë, si kërcënime ose rreziqe për të drejtat e grave dhe fëmijëve. Në të gjithë Evropën, fushatat anti-gjinore kanë çuar në fjalime publike nxitëse, duke përfshirë disa komente që mund të kualifikohen si intolerante ose të mbushura me urrejtje ndaj personave LGBTI, veçanërisht individëve transgjinorë. Në disa shtete anëtare, gjuha antigjinore është përvetësuar nga politikanët vendas, duke kërkuar të inkurajojnë pakënaqësinë dhe të portretizohen si mbrojtës të vlerave tradicionale.

ECRI vëren se nivelet dhe format e intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI ndryshojnë ndjeshëm midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Rekomandimet e mëposhtme, të cilat gjithashtu marrin parasysh gjetjet nga puna monitoruese e vendit të ECRI-t, synojnë të jenë udhëzues për të ndihmuar shtetet anëtare të parandalojnë dhe luftojnë diskriminimin dhe intolerancën ndaj personave LGBTI, në bashkëpunim me komunitetet përkatëse, duke pasur parasysh vështirësitë dhe problemet e veçanta në shtetet e ndryshme anëtare.

ECRI rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

Parimet e përgjithshme

1. t'i japë përparësi të lartë promovimit dhe arritjes së barazisë për personat LGBTI dhe luftimit të diskriminimit dhe intolerancës ndaj tyre, duke marrë të gjitha masat pozitive, duke përfshirë legjislacionin, politikat administrative dhe strategjitë kombëtare ose planet e veprimit, për të siguruar që personat LGBTI të jenë të sigurt, të mbrojtur në mënyrë të barabartë sipas ligjit dhe të aftë të gëzojnë të drejtat dhe liritë në të njëjtën masë si të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë;

8. të sigurojnë që të zhvillohet një kuadër ligjor gjithëpërfshirës, duke përfshirë dispozitat e ligjit civil, administrativ dhe penal, për të parandaluar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes anti-LGBTI, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes në internet, dhe të ndjekin penalisht gjuhën e urrejtjes anti-LGBTI me natyrë penale dhe krimet e tjera të urrejtjes. Gjuha e urrejtjes anti-LGBTI me natyrë penale dhe krimet e tjera të urrejtjes nuk duhet të marrin dënime më të ulëta se gjuha e urrejtjes me natyrë penale dhe krimet e tjera të urrejtjes të motivuara nga baza të tjera të mbrojtura;

Parandalimi

Trajnimi i Profesionistëve të Medias

42. të inkurajohen organet rregullatore publike të medias që të organizojnë seanca trajnimi për profesionistët e medias mbi standardet ligjore dhe të tjera për barazinë LGBTI dhe mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes fobike ndaj LGBTI-së, me qëllim zbatimin e standardeve të tilla, veçanërisht në median elektronike. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ligjet kombëtare, të cilat rregullojnë median, të ndalojnë diskriminimin për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale;

Kodet e Sjelljes në Sferën Politike dhe në Sektorin e Medias

51. të inkurajojnë miratimin nga mediat e shtypura dhe elektronike, duke përfshirë mediat online, si dhe nga shoqatat e gazetarëve, të kodeve të sjelljes që kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes të synuar ndaj personave LGBTI ose mbështetësve të tyre;

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - Komenti i Përgjithshëm nr. 22: Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993

5. Në përputhje me nenin 20, asnjë manifestim i fesë ose besimit nuk mund të përbëjë propagandë për luftë ose mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Siç deklarohet nga Komiteti në komentin e tij të përgjithshëm nr. 11 [19], shtetet palë janë të detyruara të nxjerrin ligje për të ndaluar akte të tilla.

Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuarmë 7 prill 2020¹⁰

ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikavetë Përgjithshme Nr.15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kundër personave LGBTI dhe romë. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.

Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 04.11.2023

Anëtarët e komunitetit LGBTIQ vazhdojnë të përjetojnë agresion fizik dhe gjuhë urrejtjeje, veçanërisht në mediat sociale.

¹⁰ Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 04.11.2024

Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ është ende shumë i përhapur, veçanërisht në aksesin në kujdes shëndetësor, arsim, drejtësi, punësim dhe strehim.

Gjuha e urrejtjes mbetet një shqetësim serioz.

Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 04.11.2025:

Mbrojtja ligjore e të drejtave të personave LGBTIQ duhet të përmirësohet dhe të përafrohet më tej me acquis të BE-së. Për më tepër, personat LGBTIQ përballen me nivele të larta diskriminimi dhe mungon mbledhja gjithëpërfshirëse e të dhënave.

IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.

Z.Z.I , avokat me profesion dhe person i cili merr pjesë në jetën publike, ka qenë i ftuar në dy emisione televizive, emisionin “Living Day”, më datë 03.10.2025, në Televizionin Vizion Plus dhe emisionin “Studio Live”, më datë 10.12.2025, në Televizionin Report. Tema e diskutimit në të dy emisionet ka qenë miratimi i ligjit “Për barazinë gjinore”, proces i cili është zhvilluar në një klimë debati dhe polemikash. Z.I. , parashtoi se, deklaratat e tij janë bërë në ushtrim të lirisë së shprehjes dhe lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Vlerësimi i Komisionerit.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t'i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe i të drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare. Të gjithë personat, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, identiteti gjinor ose karakteristikat e seksit, kanë të drejtën të gëzojnë mbrojtje nga çdo lloj forme diskriminimi.

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese. Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është gjithashtu një e drejtë Kushtuese. Kjo liri përfshin lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit, si dhe të drejtën për të manifestuar dhe shprehur fenë dhe besimin. Nëse aspekti i parë, pra ai i brendshëm, nuk i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi, aspekti i dytë, ai i manifestimit të mendimit, fesë dhe besimit, është subjekt i kufizimeve për mbrojtjen e interesave publikë dhe të drejtave të të tjerëve.

Liria e shprehjes dhe liria për të shprehur/manifestuar fenë dhe besimin, janë subjekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur". (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shkruese shkaqesh, duke përfshirë orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e seksit, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë “gjuhë urrejtje”, e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes si dhe liria e fesë dhe besimit në raport, me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pavarësisht orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë e shprehjes e ushtruar në kundërshtim me këtë ligj është e ndaluar.

Gjithashtu, rezulton plotësisht e qartë se, kufizimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, të pretenduar nga subjekti, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi i personave për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, shkaqe këto që garantojnë kuadrin mbrojtës për komunitetin e personave LGBTI¹¹.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....¹²”.

Në këtë mënyrë përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohen si e drejta e shprehjes, ashtu edhe ajo e fesë dhe besimit, kufizimi është vendosur bazuar në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në rastin konkret për mbrojtjen nga diskriminimi të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

¹¹ Termi LGBTI, është një term ombrellë për: Lezbike (L), Gej (G), Biseksual (B), Transgjinor (T) dhe Interseks (I).

¹² *Engels and Others* kundër Hollandës, 1976.

Në vlerësimin e faktit nëse gjuha e përdorur, arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t'u konsideruar gjuhë urrejtje në kuptim të nenit 3, pika 8, të LMD dhe rrjedhimisht një formë diskriminimi, e ndaluar nga ligji, Komisioneri do të bazohet në udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ dhe duke marrë parasysh faktorët/elementët e përfshirë në Rekomandimin Nr.15 të ECRI-t dhe Rekomandimin KM/Rek (2022) 16, të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe ndërveprimi ndërmjet tyre.

Sipas Rekomandimit Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”¹³, “*shprehja*” në këtë Rekomandim përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Gjithashtu, përfshin përdorimin e një sjelljeje të caktuar - siç janë gjestet - për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.

Kodi i Transmetimit të Mediave Audiovizive, gjithashtu përcakton në pikat 9 e 28, të tij se, “*shprehja*” përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. “*Shprehja*” përfshin gjithashtu edhe përdorimin e sjelljes - si p.sh. gjesteve - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim apo formave të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

Neni 3/8 i ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon gjuhën e urrejtjes, në çdo formë të shprehjes në publik dhe me çdo mjet. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehja është realizuar nëpërmjet fjalëve dhe në mënyrë publike, pasi gjuha në shqyrtim e përdorur nga z. Z.I është bërë në një platformë publike, siç është media, dhe se media audiovizive, përfshihet në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Liria e pasjes së mendimeve ose opinioneve dhe liria e ndërgjegjes fesë dhe besimit, janë të drejta të cilat nuk mund të kufizohen, ndërsa shprehja ose manifestimi i tyre është objekt i kufizimeve sipas përcaktimeve të mësipërme.

Relacioni Shpjegues që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”, thekson se, një nga elementët domethënës të konceptit se çfarë është gjuha e urrejtjes, lidhet me *përdorimin që synon jo thjesht të nxisë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte*. Relacioni Shpjegues i Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, në pikën 16, të tij, përcakton se, vlerësimi nëse ekziston rreziku i akteve përkatëse, pra i akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, që të ndodhin duhet të merret duke pasur parasysh

¹³ Referuar, pikës 11, të Relacionit Shpjegues, që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

rrethanat specifike në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes dhe konkretisht duhet të vlerësohen këto elementë:

- (a) *kontekstin në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë* (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes).
- (b) *aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët* (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose në komunitet);
- (c) *natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur* (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi);
- (d) *kontekstin e komenteve specifike* (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati);
- (e) *mediumin (formatin) e përdorur* (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt"); dhe
- (f) *natyrën e publikut* (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi)

Në shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, theksohet se, meqenëse gjuha e urrejtjes mbulon një sërë shprehjesh urrejtjeje, të cilat ndryshojnë në ashpërsinë e tyre, dëmin që shkaktojnë dhe ndikimin e tyre te anëtarët e grupeve të veçanta në kontekste të ndryshme, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që një sërë masash për të parandaluar dhe luftuar efektivisht gjuhën e urrejtjes. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse duhet të përputhet plotësisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata) dhe duhet të bëjë dallimin ndërmjet:

- i. gjuhës së urrejtjes që është e ndaluar sipas ligjit penal;
- ii. Gjuhës së urrejtjes që nuk arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për përgjegjësinë penale, por megjithatë i nënshtrohet *ligjit civil ose administrativ*;
- iii. Llojet fyese ose të dëmshme të shprehjes, të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u kufizuar në mënyrë legjitime sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por megjithatë kërkojnë përgjigje alternative, siç janë: kundër-fjalimi dhe kundërmasa të tjera; masat që nxisin dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor, duke përfshirë mediat dhe mediat sociale, dhe aktivitete përkatëse edukative.

Në Shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, theksohet se, në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin se cila lloj përgjegjësie, nëse ka vend për përgjegjësi, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, duhen ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimi ndërmjet tyre: - *përmbajtja e shprehjes*; - *konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes*; - *qëllimi i folësit*; - *roli*

dhe statusi i folësit në shoqëri; - si shpërndahet apo përforcohet shprehja; - aftësia e shprehjes për të çuar në pasojë të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; - natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

Duke iu referuar përmbajtjes së diskutimeve në tërësi, gjuhës dhe fjalëve të përdorura nga z. Z.I , në mënyrë të veçantë shprehjet: *“Të vrasin veten”*. *“Këta që martohen kështu, që bëjnë martesë burrë me burrë, grua me grua, unë dua t’i zhduk të tërë.”*, *“Këta janë kundër njerëzimit. Këta janë kundër natyrës njerëzore. Këta janë kundër besimit në zot. Këta janë rundimente të shoqërisë. Duhet të zhduken.”*, *“... nuk është martesë, është genocid.”*, *“Kjo bashkëjetesë është për të vrarë popullsinë”*, *“Këto janë krime kundër njerëzimit”* *“Unë nuk i quaj njerëz në radhë të parë pjesëtarët e atij grupi”*, *“Nuk i llogaris fare për qenie të gjalla, për njerëz. Bagëti, tutje....turmë amorfe.” një pakicë pederastësh, të “damllosurit”, “Këta pederastët tanë.”* *“Në profesionin tim, kam gjënë më të lehtë, të kollajtë, që ti them, zotëri larg nga zyra ime, nuk ju shërbej njerëzve të tillë. Nuk kam qejf, nuk kam dëshirë. Bile të shoh nuk kam dëshirë, jo më të të shërbej. I thjeshtë. Më i thjeshtë nuk ka ku të shkojë...”*, Komisioneri vlerëson se, pikëpamjet e ankuesit janë të afta të shkaktojnë diskriminim dhe urrejtje ndaj personave që i përkasin komunitetit LGBTI.

Komisioneri vlerëson se disa nga shprehjet e përdorura janë aq të ashpra sa mohojnë natyrën njerëzore të personave LGBTI. Shprehjet e përdorura shkojnë përtej shprehjes së opinionit, madje edhe në terma fyese, armiqësore dhe agresive. Shprehjet e përdorura nga ankuesi përfshijnë gjithashtu nxitje të drejtpërdrejta ndaj dhunës, të afta për të shkaktuar ndjenja frike.

Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, rezulton se personat LGBTI portretizohen si persona të cilët janë një kërcënim për traditën apo vlerat shoqërisë. Këta persona, sipas referimeve të bëra nga subjekti konsiderohen si persona që çenojnë familjen tradicionale, që kërkesat e tyre janë antivilera dhe që martesë brenda të njëjtës gjini përbën genocid.

Referuar gjuhës së përdorur nga z.Z.I , Komisioneri konstaton se personat LGBT gjithashtu portretizohen si persona të cilët me kërkesat e tyre çenojnë interesat dhe të drejtat e fëmijëve, duke i referuar si krime kundër njerëzimit. Një gjë e tillë është e pabazuar dhe bën që personat e këtij komuniteti të perceptohen negativisht nga publiku dhe të nxisin ndjenja të mospranimi dhe përjashtimit.

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjytimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të orientimit seksual identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë personat LGBTI si kërcënim për shoqërinë apo duke i cilësuar si akte kriminale kërkesat e tyre, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga z. Z.I stigmatizon personat e komunitetit LGBTI duke i etiketuar ata në një mënyrë negative dhe metribute të pavërteta.

Gjuha e përdorur nga z.Z., është përcjellë në një kontekst kur procesi i miratimit të ligjit “Për barazinë gjinore”, ka shkaktuar debate dhe tensione në shoqëri. Gjuha e përdorur dhe e shpërndarë

në një mjedis shoqëror ku homofobia dhe transfobia janë të theksuara dhe paraqesin një fenomen shqetësues, shton mundësinë që të nxiten akte frikësimi, armiqësimi apo diskriminimi ndaj personave LGBTI që drejtohen në rastin konkret.

Duke qenë një avokat dhe figurë publike, z.I. , ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezulton se z. Z.I. , është person aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, ai mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e ndryshme.

Komisioneri vlerëson faktin se, kur shprehjet dhe deklaratimet bëhen nga një personazh i njohur publik në media, në një fashë orare me një audiencë të konsiderueshme, lirisht e lehtësisht të aksesueshme, atëherë tek një pjesë e publikut, afektojnë panikun, frikën, ankthin për familjen, nga personat LGBTI, duke nxitur rrjedhimisht përcëim e urrejtje ndaj këtij komuniteti.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive është shumë më e fuqishme dhe arrin te një publik shumë të gjerë.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga subjekti krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBTI. Në çështjen Féret kundër Belgjikës¹⁴, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirëinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje”*.

Edhe pse deklaratat e bëra nga z. Z.I. , nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, anëtarët e komunitetit LGBTI, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit. Këto deklarata edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklarata që nxisin urrejtje ndaj personave LGBTI.

Duke ju rikthyer çështjes Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....ndonëse deklaratat e ankuesit nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar – anëtarë të komuniteteve të emigrantëve/refugjatëve, ata i shihnin ata kolektivisht nën një dritë negative dhe i portretizonin si kontingjent krimi dhe oportunist të prirur për të përfituar nga rezidenca e tyre në Belgjikë”* Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e mësipërme të çështjes Féret kundër Belgjikës, thekson në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*¹⁵, se:

¹⁴ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

¹⁵ GJEDNJ, *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

“diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e *Firmës Feryn (Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008)*, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cënonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në një sërë vendimmarrjesh, duke përfshirë *Perinçek, Le Pen v. France; Kasymakhunov dhe Saybatalov v. Russia; Vejdeland dhe të tjerë v. Sweden; Beizaras dhe Levickas v. Lithuania dhe Féret v. Belgium*, GJEDNJ ka zgjeruar konceptin e gjuhës së urrejtjes duke përfshirë në të nxitjen e diskriminimit, të cilën e konsideron një *“formë të nxitjes së intolerancës në shoqëri, e cila, së bashku me nxitjen e urrejtjes ndaj një apo disa individëve, përbën një nga kufijtë që nuk duhet të kapërcehen kurrë në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga asnjë individ apo subjekt”*. Me referencë në vendimmarrjet e këtyre çështjeve, GJEDNJ shprehet se kufizimi i nevojshëm i lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike shtrihet edhe mbi deklaratat negative të bëra publikisht ndaj një grupimi (etnik, fetar ose tjetër) që mbartin konotacion fyes, tallës, shpifës dhe portretizojnë në një mënyrë negative të gjithë këtë grupim popullsie¹⁶.

Po kështu, në vendimmarrjen *Beizaras dhe Levickas v. Lithuania*¹⁷, GJEDNJ u shpreh se hezitimi i autoriteteve lituaneze për të trajtuar me seriozitet përmbajtjet diskriminuese online që përmbanin elemente të gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes mbi bazat e orientimit seksual përbënte shkelje të së drejtës së individëve me orientim të ndryshëm seksual për jetë private pa diskriminim (shkelje e nenit 8 në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së).

Në *Lilliendahl v. Iceland*¹⁸, aplikanti pretendoi shkelje të lirisë së tij të shprehjes, pasi autoritetet islandeze e kishin dënuar për gjuhë urrejtjeje për shkak të postimeve dhe publikimeve të tij online që përfshinin deklaratat se homoseksualët janë *“devijantë seksualë”* dhe duhet *“të sabotohen nga shoqëria”*. GJEDNJ u shpreh se në këtë rast kufizimi i lirisë së shprehjes së aplikantit kishte qenë i nevojshëm, i ligjshëm dhe proporcional në një shoqëri demokratike, duke vënë në dukje se komentet përbënin gjuhë urrejtjeje dhe kishin për qëllim portretizimin negativ dhe nxitjen për diskriminim ndaj individëve LGBTI. Ky rast përforcoi parimin se gjuha e urrejtjes në mediat

¹⁶ Perinçek, op. cit., paragraf 206; Le Pen kundër Francës, vendim i datës 10 maj 2010, kërkesa nr. 55173/00; Kasymakhunov dhe Saybatalov kundër Rusisë, vendim i datës 14 mars 2013, kërkesa nr. 26261/05 etj.; Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, vendim i datës 9 shkurt 2012, kërkesa nr. 1813/07, paragraf 55; Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë, vendim i datës 14 janar 2020, kërkesa nr. 41288/15, paragraf 125; Féret kundër Belgjikës, vendim i datës 16 korrik 2009, kërkesa nr. 15615/07, paragraf 73.

¹⁷ Beizaras and Levickas v. Lithuania (2020), Aplikimi Nr.: 41288/15.

¹⁸ Lilliendahl v. Iceland (2021), Aplikimi Nr.:29297/18.

sociale duhet të merret seriozisht nga autoritetet shtetërore dhe të kufizohet për të mbrojtur dinjitetin dhe sigurinë e individëve LGBTI në sytë e shoqërisë.

Në çështjen *Lenis kundër Greqisë*¹⁹, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ankuesi, një Mitropolit i Lartë i Kishës Ortodokse Greke, nuk mund të përfitonte nga mbrojtja e lirisë së shprehjes (Neni 10), duke zbatuar nenin 17 të Konventës. Në vitin 2015, ankuesi kishte publikuar në *blogun* e tij një artikulli homofobik, kur Parlamenti Grek ishte gati të debatonte legjislacionin e propozuar që prezantonte bashkimet civile për çiftet e të njëjtit seks. Gjykata vlerësoi se artikulli shkonte shumë përtej kritikës fetare: ai mohonte natyrën njerëzore të personave homoseksualë me shprehje si *"Ata nuk janë njerëz! Ata janë shtrembërime të natyrës!"*, *"skuma e shoqërisë, njerëz marginalë, me të meta, të poshtëruar, njerëz të errësirës"*, *"të mallkuarit e Shoqërisë"* dhe *"njerëz me çrregullim mendor, më të rrezikshëm se ata në çmendina"*. Njëkohësisht, artikulli nxiste dhunë me thirrje të drejtpërdrejta si *"këputi mbi ta"*, *"dënojini ata"*, *"nxijini ata"* dhe *"mos ngurroni"*. Gjykata vlerësoi se këto shprehje, të marra në tërësi, ishin të afta të shkaktonin frikë dhe terror. Gjykata vlerësoi se, edhe pse kritika ndaj disa stileve të jetesës për arsye morale ose fetare nuk ishte në vetvete e përjashtuar nga mbrojtja sipas nenit 10 të Konventës, kur vërejtjet shkonin deri aty sa t'u mohonin personave LGBTI natyrën e tyre njerëzore dhe shoqëroheshin me nxitje për dhunë, atëherë duhej të merrej në konsideratë përfshirja e nenit 17 (ndalim i abuzimit me të drejtat) të Konventës. Përfundimisht Gjykata vlerësoi se, Konventa nuk ishte shkelur, pasi pikëpamjet e tij kishin qenë të prirura të shkaktonin diskriminim dhe urrejtje.

Për këtë arsye, zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së është i domosdoshëm për të adresuar këtë problem. Kjo përfshin jo vetëm ndalimin e gjuhës së urrejtjes, por gjithashtu mbrojtjen e individëve nga diskriminimi dhe sulmet verbale që kanë për qëllim të dëmtojnë dinjitetin dhe lirinë e shprehjes.

Komisioneri konstaton se, një nga çështjet më të rëndësishme është lufta kundër gjuhës së urrejtjes, e cila vazhdon të mbetet një problem i rëndësishëm në Shqipëri. Gjuha e urrejtjes, që shpesh përdoret në komunikimin publik dhe *online*, është një shkelje e drejtpërdrejtë e dinjitetit njerëzor dhe një rrezik për rendin shoqëror dhe kohezionin e shoqërisë.

Personat e komunitetit LGBTI kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë subjekte të homofobisë, transfobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të vulnerabilitetit të këtij grupimi është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave.

Komisioneri, vlerëson të theksojë se, jo mbi të gjitha grupet shoqërore shprehje të tilla rëndojnë njëlloj. Është në vëmendje të Komisionerit, që vetë shteti Shqiptar, ka njohur si strukturalisht dhe sistematikisht të diskriminuara disa grupe shoqërore nga organet publike dhe vetë shoqëria. Kjo provohet edhe nga strategjitë e veçanta që Qeveria ka hartuar, si p.sh: Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK) 2021-

¹⁹ *Lenis kundër Greqisë*, Aplikimi Nr. 47833/20, Vendimi datë 27.6.2023.

2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021-2025”), Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) për komunitetin LGBTI (2021-2027), etj. Për këtë arsye shprehjet e përdorura në tejkallim të lirisë së shprehjes duke portretizuar negativisht këto grupe shoqërore, nëpërmjet denigrimit, dezinformimit si dhe amplifikimit të paragjykimeve dhe stereotipeve negative, rëndojnë disproporcionalisht dhe krijojnë sjellje diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga z. Z.I , përbën gjuhë urrejtje kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikat e seksit. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura nga z. Z.I janë në tejkallim të lirisë së shprehjes, ndërgjegjes, fesë dhe besimit dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi, është i domosdoshëm dhe proporcional.

Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtës për barazi dhe mosdiskriminim, vendosin detyrime si ndaj autoriteteve publike ashtu dhe subjekteve private, që jo vetëm të mos përdorin gjuhë urrejtje, por edhe të marrin masa për ta parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes.

Legjislacioni i posaçëm që rregullon ushtrimin e veprimtarisë së mediave audiovizive, ligji nr. 97/2013 “*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit të Mediave Audiovizive, i miratuar nga AMA, vendos detyrime mbi OSHMA audiovizive që, në transmetimet audiovizive nuk duhet të përdoren shprehje, që përmbajnë gjuhë urrejtje dhe se duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar, kundërvepruar, kundërshtuar dhe hedhur poshtë çdo shprehje të tillë. Pra, media audiovizive, jo vetëm që nuk duhet të përdori gjuhë urrejtje në transmetimet e saj, por duhet të marrë masa për parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes.

Komisioneri vlerëson se, Televizioni Vizion Plus dhe Televizioni Report Tv, janë përgjegjës për përhapjen e deklaratave të bëra nga z. Z.I , të cilat përbëjnë gjuhë urrejtje, jo vetëm se gjatë zhvillimit të debatit drejtuesit respektivë të dy emisioneve nuk kanë kundërvepruar dhe kundërshtuar në mënyrë aktive për të hedhur poshtë gjuhën e urrejtjes së përdorur nga i ftuari z. I. , por edhe për shkak të përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Pavarësisht se emisioni ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë/“live”, Televizioni Vizion Plus dhe Televizioni Report Tv, e kanë shpërndarë dhe publikuar emisionin ose fragmente nga emisioni, me tituj të papërshtatshëm, duke perifrastuar deklaratime të z. I. që përbëjnë gjuhë urrejtje.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht qëndrimit dhe masat e deklaruar nga ana e Televizioni Vizion Plus dhe Televizioni Report Tv dhe faktit se, ndaj tyre është marrë masa administrative nga ana e AMA, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës, në kushtet kur masat e marra nuk rezultojnë

efektive pasi, deri në momentin e daljes së këtij vendimi, të dy emisionet ku janë përhapur deklaratat e z. Z.I , të cilat përbëjnë gjuhë urrejtje ndaj personave LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikat e seksit, emisioni “Living Day”, i datës 03.10.2025, transmetuar në Televizionin Vizion Plus dhe emisioni “Studio Live”, i datës 10.12.2025, transmetuar në Televizionin Report Tv, vazhdojnë të jenë të publikuar të plotë, në kanalet respektive zyrtare të Televizionit Vizion Plus dhe Televizionit Report Tv, në rrjetin social *youtube*²⁰, Komisioneri vlerëson se, Televizioni Vizion Plus/Shoqëria Media Vizion sh.a dhe Televizioni Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duhet të mbajnë përgjegjësi për përhapjen e gjuhës së urrejtjes.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i z. Z.I që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj. Nga ana e Televizionit Vizion Plus dhe Televizionit Report Tv duhet të merren masa për të hequr përmbajtjen e deklarimeve të përbëjnë gjuhë urrejtje, të publikuara kanalet e tyre respektive zyrtare në rrjetin social *youtube*, si dhe të bëjnë deklaratë publike nëpërmjet të cilës të distancohen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTI.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, si pasojë e gjuhës së përdorur nga z. Z.I në emisionin “Living Day”, të datës 03.10.2025, transmetuar në Televizionin Vizion Plus dhe emisionin “Studio Live”, të datës 10.12.2025, transmetuar në Televizionin Report Tv.

²⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=TxueHiEgata>

²⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=07-EFFwZxVI>

2. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, si pasojë e përhapjes nga ana Televizionit Vizion Plus/Shoqërisë Media Vision sh.a dhe Televizionit Report Tv/Shoqërisë MTSC sh.p.k, të gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. Z.I , sipas pikës 1, të këtij vendimi.
3. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi z. Z.I , në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
4. Në referim të pikës 2 të këtij vendimi, Televizioni Vizion Plus/Shoqëria Media Vision sh.a dhe Televizioni Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duhet të marrin masat e mëposhtme:
 - a. Të bëjnë një deklaratë publike me anë të të cilës distancohen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI.
 - b. Të marrin masa për heqjen e deklarimeve të përbëjnë gjuhë urrejtje, nga përmbajtja e emisionit “Living Day”, të datës 03.10.2025, transmetuar në Televizionin Vizion Plus dhe emisionit “Studio Live”, të datës 10.12.2025, transmetuar në Televizionin Report Tv, të publikuar në kanalet e tyre respektive zyrtare në rrjetin social *youtube*²¹.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, z. Z.I , Televizioni Vizion Plus/Shoqëria Media Vision sh.a dhe Televizioni Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Orientimi seksual, identiteti gjinor, karakteristikat e seksit
Lloji i vendimit: Diskriminim_Gjuhë urrejtje

²¹ <https://www.youtube.com/watch?v=TxueHiEgata>

²¹ <https://www.youtube.com/watch?v=07-EFFwZxVI>